

**LIGJ**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR KUVENDIN E**  
**REPUBLIKËS SË MAQEDONISË**

**Neni 1**

Në Ligjin për Kuvendin e Republikës së Maqedonisë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 104/2009), në nenin 27 paragrafi (1) në alinenë 5 lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje dhe shtohen dy aline të reja si vijojnë:

„- jep pëlqim financiar të planit vjetor për punësim,  
- miraton vendim për përcaktimin e vlerës së pikës për nëpunësit e Kuvendit dhe.“.

Alineja 6 bëhet aline 8.

**Neni 2**

Neni 40 ndryshohet si vijon:

“(1) Shërbimi i Kuvendit (në tekstin e mëtejme: Shërbimi) kryen punë profesionale, administrative dhe punë të tjera për nevojat e Kuvendit, të Kryetarit të Kuvendit, të trupave punues dhe të deputetëve. Shërbimi kryen punë profesionale, administrative dhe punë të tjera për nevojat e Komitetit për Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive dhe për trupat e tjerë të Kuvendit.

(2) Shërbimi funksionon si shërbim unik.

(3) Funksionimi unik i Shërbimit sigurohet me bashkëpunim të ndërsjellë të njësive organizative dhe me harmonizimin e punës së tyre.

(4) Funksionimin unik të Shërbimit e siguron sekretari i përgjithshëm i Kuvendit (në tekstin e mëtejme: sekretari i përgjithshëm).“.

**Neni 3**

Pas nenit 40 shtohen 19 nene të reja 40-a, 40-b, 40-v, 40-g, 40-d, 40-gj, 40-e, 40-zh, 40-z, 40-x, 40-i, 40-j, 40-k, 40-ll, 40-l, 40-m, 40-n, 40-nj dhe 40-o dhe 6 tituj të rinj, si vijojnë:

“1. Organizimi i brendshëm i shërbimit

**Neni 40-a**

(1) Në Shërbim formohen njësitë organizative themelore dhe njësitë organizative në përbërje.

(2) Njësitë organizative formohen sipas llojit, ngjashmërisë dhe lidhshmërisë së ndërsjellë të detyrave të punës.

(3) Gjatë formimit të njësive organizative nuk mund të ketë përputhje të fushëveprimit të tyre të punës.

**Neni 40-b**

(1) Në Shërbimin si njësi organizative themelore mund të formohen: kabinet, sektorë dhe njësi të veçanta organizative.

(2) Kabineti formohet për nevojat e Kryetarit të Kuvendit. Në kabinet formohen së paku dy seksione. Me kabinetin udhëheq shafi i kabinetit i cili përgjigjet para Kryetarit të Kuvendit dhe para sekretarit të përgjithshëm.

(3) Sektori formohet për të bashkuar më shumë punë dhe detyra të lidhura në mënyrë të ndërsjellë, si dhe për të organizuar, ndjekur dhe

koordinuar punët në kompetencë të seksioneve në përbërjen e tij dhe avancimin e bashkëpunimit të tyre të ndërsjellë. Në sektor formohen së paku dy seksione. Me sektorin udhëheq udhëheqësi i sektorit i cili përgjigjet para sekretarit të përgjithshëm. Udhëheqësi i sektorit në njësinë e veçantë organizative Instituti Parlamentar përgjigjet para udhëheqësit të njësisë së veçantë organizative.

(4) Njësitë e veçanta organizative formohen në pajtim me ligjin dhe për to nuk vlejné kufizimet për numrin e vendeve të punës. Personi i cili udhëheq me njësinë e veçantë organizative përgjigjet para sekretarit të përgjithshëm, ndërsa udhëheqësi i njësisë së veçantë organizative Instituti Parlamentar përgjigjet edhe para Këshillit Drejtues.

#### Neni 40-v

(1) Në përbërje të njësive organizative themelore nga neni 40-b paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji, formohen seksione për kryerje të drejtpërdrejtë të punëve dhe detyrave të njësive organizative themelore.

(2) Në seksion sistematizohen së paku pesë vende pune së bashku me udhëheqësin e seksionit. Me seksionin udhëheq udhëheqësi i seksionit i cili përgjigjet para udhëheqësit të sektorit.

#### Neni 40-g

(1) Në Shërbim sistematizon vendet e punës për këshilltarët shtetërorë të Kuvendit në fusha të ndryshme në kompetencë të Kuvendit.

(2) Këshilltarët shtetërorë të Kuvendit për punën e tyre përgjigjen para sekretarit të përgjithshëm.

#### Neni 40-d

(1) Në Shërbim mund të formohen edhe njësi organizative projektuese.

(2) Njësitë organizative projektuese formohen për zbatimin e projektit në kohë të caktuar deri në përfundim të tij. Të punësuarit në njësitë projektuese punësohen në kohë të caktuar, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se kohëzgjatja e projektit.

#### Neni 40-gj

(1) Aktin për organizim të brendshëm dhe aktin për sistematizim të vendeve të punës në Shërbim i miraton sekretari i përgjithshëm me propozim të Këshillit të Shërbimit të Kuvendit.

(2) Aktet nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen me pëlqimin e marrë nga Kryetari i Kuvendit.

(3) Me aktin për organizim të brendshëm rregullohen:

- lloji dhe numri i njësive organizative,  
- fushëveprimi i punës së njësive organizative dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella dhe

- udhëheqja me njësitë organizative dhe përgjegjësia.

(4) Pjesë përbërëse e aktit të organizimit të brendshëm është pasqyra grafike e organizimit të Shërbimit (organogrami).

(5) Në aktin e sistematizimit të vendeve të punës në Shërbim, numri i vendeve të punës dhe numri i realizuesve sistematizohen në pajtim me nevojën për kryerje efikase të kompetencave të Kuvendit.

(6) Aktet nga paragrafi (1) i këtij neni, sekretari i përgjithshëm i dërgon në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës për shkak të informimit dhe i publikon në ueb faqen e Kuvendit.

#### Neni 40-e

(1) Shërbimin e përbëjnë nëpunësit e Kuvendit dhe personat e punësuar në Shërbim të cilët kryejnë punë ndihmëse-teknike.

(2) Nëpunësit e Kuvendit janë persona me status të nëpunësve administrativë. Për nëpunësit e Kuvendit zbatohen dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, Ligjit për nëpunës administrativë dhe rregullat për marrëdhëniet e punës, përveç nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(3) Personat e punësuar në Shërbim të cilët kryejnë punë ndihmëse-teknike nuk kanë status të nëpunësve administrativë edhe për ta zbatohen dispozitat e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik dhe rregullat për marrëdhëniet e punës.

### 2. Këshilli i Shërbimit të Kuvendit

#### Neni 40-zh

(1) Sekretari i përgjithshëm formon Këshill të Shërbimit të Kuvendit (në tekstin e mëtutjeshëm: Këshill), si trup i tij këshillëdhënës, i cili përpilon analizë funksionale; propozon akt për organizimin e brendshëm dhe akt për sistematizimin e vendeve të punës në Shërbim, të përpiluara në bazë të analizës funksionale; propozon plotësimin e vendeve të punës në Shërbim nëpërmjet internetit dhe konkursit publik; i ndihmon sekretarit të përgjithshëm në lidhje me funksionimin dhe koordinimin e Shërbimit dhe kryen punë tjera.

(2) Këshillin e përbëjnë udhëheqësit e njësisve organizative themelore, ndërsa në punën e tij mund të marrin pjesë edhe këshilltarët shtetërorë të Kuvendit.

(3) Me Këshillin udhëheq Sekretari i përgjithshëm.

(4) Këshilli për çdo mbledhje të mbajtur mban procesverbal.

### 3. Klasifikimi i vendeve të punës të nëpunësve të Kuvendit

#### Neni 40-z

(1) Vendet e punës të nëpunësve të Kuvendit klasifikohen në tri kategori në pajtim me kriteret e Ligjit për nëpunës administrativë:

- kategoria B – nëpunës udhëheqës të Kuvendit,
- kategoria V – nëpunës profesionalë të Kuvendit dhe
- kategoria G – nëpunës ndihmës-profesionalë të Kuvendit.

(2) Në kuadër të secilës kategori nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen më shumë nivele të vendeve të punës të nëpunësve të Kuvendit.

#### Neni 40-x

(1) Në kuadër të kategorive përcaktohen nivelet dhe titujt në vijim për nëpunësit e Kuvendit:

1. Për kategorinë B

- B1 këshilltar shtetëror i Kuvendit, nëpunës udhëheqës i Kuvendit nga niveli i parë me shifër SOB 01 01 B01000,

- B2 udhëheqës i sektorit, nëpunës udhëheqës i Kuvendit nga niveli i dytë me shifër SOB 01 01 B02000,

- B3 ndihmës udhëheqës i sektorit, nëpunës udhëheqës i Kuvendit nga niveli i tretë me shifër SOB 01 01 B03000 dhe

- B4 udhëheqës i seksionit, nëpunës udhëheqës i Kuvendit nga niveli i katërt me shifër SOB 01 01 B04000.

#### 2. Për kategorinë V

- V1 këshilltar, nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i parë me shifër SOB 01 01 V01000,

- V2 bashkëpunëtor i lartë, nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i dytë me shifër SOB 01 01 V02000,

- V3 bashkëpunëtor, nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i tretë me shifër SOB 01 01 V03000 dhe

- V4 bashkëpunëtor i ri, nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i katërt me shifër SOB 01 01 V04000.

#### 3. Për kategorinë G

- G1 referent i pavarur, nëpunës ndihmës-profesional i Kuvendit nga niveli i parë me shifër SOB 01 01 G01000,

- G2 referent i lartë, nëpunës ndihmës-profesional i Kuvendit nga niveli i dytë me shifër SOB 01 01 G02000,

- G3 referent, nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i tretë me shifër SOB 01 01 G03000 dhe

- G4 referent i ri, nëpunës ndihmës-profesional i Kuvendit nga niveli i katërt me shifër SOB 01 01 G04000.

(2) Shifrat e nëpunësve të Kuvendit nga paragrafi (1) i këtij neni do të inkorporohen në Katalogun për vende të punës në sektorin publik të cilin e udhëheq Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

#### Neni 40-i

Për nevojat e kryetarit, nënkryetarëve dhe sekretarit të përgjithshëm, në aktin për sistematizimin e vendeve të punës, si vende të veçanta të punës përcaktohen nëpunës të kabinetit me numrin si vijon:

- pesë vende të punës të nëpunësve të kabinetit për nevojat e Kryetarit të Kuvendit,

- një vend pune i nëpunësit të kabinetit për nevojat e secilit nënkryetar të Kuvendit dhe

- tre vende të punës të nëpunësve të kabinetit për nevojat e sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit.

#### Neni 40-j

Për nevojat e kryetarit, nënkryetarëve dhe sekretarit të përgjithshëm, për shkak të realizimit të detyrave të veçanta të punës plotësohen vende të punës – këshilltarë të veçantë, me numrin në vijim:

- pesë vende të punës të këshilltarëve të veçantë për nevojat e Kryetarit të Kuvendit,

- një vend pune i këshilltarit të veçantë për nevojat e secilit nënkryetar të Kuvendit dhe

- tre vende të punës të këshilltarëve të veçantë për nevojat e sekretarit të përgjithshëm të Kuvendit.

#### 4. Mënyra e plotësimit të vendeve të punës

##### Neni 40-k

(1) Plotësimi i vendit të punës në Shërbim kryhet nëpërmjet zbatimit të procedurës për:

- punësim, nëpërmjet shpalljes së konkursit publik,
- avancim, nëpërmjet shpalljes së konkursit intern dhe
- mobilitet, nëpërmjet sistemimit ose marrjes.

(2) Procedurat për plotësimin e vendit të punës nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohen në procedurë transparente, të drejtë dhe konkurruese, duke e respektuar parimin e përfaqësimit adekuat dhe të drejtë.

(3) Plotësimi i vendeve të punës nëpërmjet shpalljes së konkursit intern është prioritet gjatë plotësimit të vendit të punës në Shërbimin.

(4) Procedurat për plotësimin e vendit të punës nga paragrafi (1) alinetë 1 dhe 2 të këtij neni, zbatohen pas pëlqimit të marrë paraprakisht për mjete të siguruar financiare nga Kryetari i Kuvendit, në kuadër të mjeteve të siguruar në buxhetin e Kuvendit dhe planin vjetor për punësim.

##### Neni 40-II

(1) Procedurat për punësim dhe avancim të nëpunësve të Kuvendit zbatohen në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

(2) Procedurat për mobilitet të nëpunësve të kuvendit zbatohen në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik.

(3) Procedurat për plotësimin e vendeve të punës të personave ndihmës-teknikë zbatohen në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat për marrëdhënie pune.

(4) Procedurat për plotësimin e vendit të punës përmes lidhjes së marrëveshjes për punësim në kohë të caktuar të punës sipas cilësdo bazë, si dhe për angazhimin e ekspertëve dhe personave të tjerë, zbatohen pas pëlqimit të marrë paraprakisht për mjetet financiare të siguruar nga kryetari i Kuvendit, në korniza të mjeteve të siguruar në buxhet për Kuvendin.

#### 5. Procedura për miratimin e planit vjetor për punësim

##### Neni 40-I

(1) Sekretari i përgjithshëm është i detyruar të përgatitë Propozim-plan vjetor për punësim dhe së bashku me propozim-kërkesën buxhetore ta dorëzojë për pëlqim në Këshillin Buxhetor të Kuvendit.

(2) Këshilli Buxhetor është i detyruar të miratojë vendim për dhënien e pëlqimit financiar, përkatësisht të japë vërejtje të Propozim-planit vjetor, më së voni në afat prej 15 ditësh nga pranimi i Propozim-planit vjetor.

(3) Sekretari i përgjithshëm është i detyruar të veprojë sipas vërejtjeve, përkatësisht ta harmonizojë Propozim-planin vjetor.

(4) Pas dhënies së pëlqimit, përkatësisht pas harmonizimit të planit, sekretari i përgjithshëm është i detyruar menjëherë, e më së voni deri më 1 shtator ta miratojë planin.

(5) Sekretari i përgjithshëm planin së bashku me pëlqimin i dorëzon në Ministrinë e Financave, Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës dhe në Agjencinë për Administratë, për informim.

(6) Nëse Këshilli Buxhetor në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të Propozim-planit nuk vepron sipas kërkesës për pëlqim, konsiderohet se pëlqimi është dhënë.

#### Neni 40-m

Sekretari i përgjithshëm në Ministrinë e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, për shkak të informimit dy herë në vit dorëzon raport për realizim të planit nga neni 40-l të këtij ligji dhe atë më së voni deri më 15 korrik për periudhën janar-qershor në vitin rrjedhës, përkatësisht më së voni deri më 15 janar për periudhën korrik-dhjetor në vitin paraprak.

### 6. Rroga dhe vlera e pikës për përllogaritje të rrogës

#### Neni 40-n

(1) Komponentin bazë të rrogës të nëpunësve të Kuvendit e përbëjnë:

- pjesa e rrogës për shkallën e arsimit,
- pjesa e rrogës për nivel dhe
- pjesa e rrogës për stazh.

(2) Pjesa e rrogës për shkallën e arsimit i cili është minimum ligjor për nivelin përkatës të vendit të punës vlerësohet në këtë mënyrë:

1. Niveli i kualifikimeve/arsimit pikët, si vijon:

- Niveli i kualifikimeve VI A, 240 kredi sipas SETK ose shkallën VII/1 të përfunduar , 200 pikë,

- Niveli i kualifikimeve VI B, 180 kredi sipas SETK 175 pikë,

- Niveli i kualifikimeve VA, 60 deri në 120 kredi sipas SETK ose shkollimin e lartë 150 pikë dhe

- Niveli i kualifikimeve IV, 240 kredi sipas ECVET ose SKMAP ose arsimin e mesëm katërvjeçar 100 pikë.

(3) Pjesa e rrogës për nivelin në të cilin është sistemuar nëpunësi i kuvendit vlerësohet në këtë mënyrë:

B1-nëpunës udhëheqës i Kuvendit nga niveli i parë 671 pikë;

B2-nëpunës udhëheqës i Kuvendit nga niveli i dytë 645 pikë;

B3-nëpunës udhëheqës i Kuvendit nga niveli i tretë 528 pikë;

B4-nëpunës udhëheqës i Kuvendit nga niveli i katërt 450 pikë;

V1- nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i parë 365 pikë;

V2-nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i dytë 320 pikë;

V3-nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i tretë 300 pikë;

V4-nëpunës profesional i Kuvendit nga niveli i katërt 261 pikë;

G1-nëpunës ndihmës-profesional i Kuvendit nga niveli i parë 255 pikë;

G2-nëpunës ndihmës-profesional i Kuvendit nga niveli i dytë 235 pikë;

G3-nëpunës ndihmës-profesional i Kuvendit nga niveli i tretë 216 pikë

dhe

G4-nëpunës ndihmës-profesional i Kuvendit nga niveli i katërt 207 pikë.

(4) Pjesa e rrogës për stazhin e punës të nëpunësit të kuvendit vlerësohet në shumë prej 0,5% nga pjesët e rrogës për shkallë të arsimit dhe për nivel, për çdo vit të përfunduar të stazhit të punës, e më së shumti deri 20%.

#### Neni 40-nj

(1) Vlera e pikës për përllogaritjen e rrogave të nëpunësve të Kuvendit përcaktohet çdo vit me vendim të Këshillit Buxhetor me propozim të sekretarit të përgjithshëm, që miratohet në afat prej 15 ditësh nga dita e miratimit të buxhetit republikan, e në korniza të buxhetit të paraparë për Kuvendin dhe në bazë të numrit të përgjithshëm të nëpunësve të kuvendit të sistemuar sipas niveleve përkatëse për vitin rrjedhës.

(2) Nëse Këshilli buxhetor në afatin e përcaktuar nga paragrafi (1) i këtij neni nuk e përcakton vlerën e pikës, për llogaritjen e rrogave të nëpunësve të kuvendit llogaritet vlera e pikës së përcaktuar nga viti paraprak, deri në miratimin e vendimit.

#### Neni 40-o

(1) Nëpunësit e Kuvendit kanë të drejtë për kompensim të veçantë të rrogës për shkak të specifikës së punëve dhe detyrave, mënyrës dhe kushteve për kryerjen e tyre, disponueshmërinë e vazhdueshme, vëllimit të rritur të punës dhe punimeve të përhershme të Kuvendit.

(2) Kompensimi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk mund të jetë më i lartë se 30% nga shuma e rrogës bazë dhe i njëjti paguhet për periudhë të caktuar kohore.

(3) Kriteret për pagesën e kompensimit nga paragrafi (1) i këtij neni me akt i përcakton Sekretari i përgjithshëm.“.

#### Neni 4

Pas nenit 42 shtohet nen i ri 42-a, si vijon:

##### "Neni 42-a

Në Shërbim themelohet njësi e veçantë organizative, Seksioni - Zyra Buxhetore Parlamentare, me qëllim të avancimit të mbikëqyrjes financiare parlamentare, përpilimin e analizave profesionale financiare dhe buxhetore për nevojat e deputetëve dhe trupave punues.“.

### DISPOZITA KALIMTARE

#### Neni 5

Sekretari i përgjithshëm në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji e cakton mbledhjen e parë të Këshillit të Shërbimit të Kuvendit.

Sekretari i përgjithshëm është i detyruar që aktet nga neni 40-gj dhe 40-o paragrafi (3) të këtij ligji t'i miratojë në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, ndërsa do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2021.

Dispozitat nga neni 1 paragrafi 1 alineja 2 dhe nenet 40-k, 40-l paragrafi (2), 40-m, 40-n, 40-nj dhe 40-o paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji do të fillojnë të zbatohen nga 1 janari 2021.

Vendimin për vlerën e pikës për përllogaritje të rrogës të nëpunësve të Kuvendit, Këshilli Buxhetor e miraton në afat prej dhjetë ditësh nga dita e miratimit të Buxhetit republikan për vitin 2021.

#### Neni 6

Koha e kaluar në vendin e punës rrjedhës deri në ditën e zbatimit të akteve nga neni 5 paragrafi 2 të këtij ligji, në pajtim me Ligjin për nëpunës

administrativë, do të llogaritet në kohën e përgjithshme për përcaktimin e kushtit në procedurat për avancim.

#### **Neni 7**

Pikët për shkallën e karrierës që nëpunësi i Kuvendit i ka fituar deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, shtohen në pikat në pjesën e rrogës për nivel të përcaktuara në nenin 40-n paragrafi (3) të këtij ligji.

### **DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 8**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".